



STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

“MENAXHIMI I LIQENIT TË OHRIT DHE DRINIT TË ZI NGA
KOMUNA E STRUGËS DHE KOMUNA E OHRIT”

MENTOR:
Prof. Dr. Agni Aliu

KANDIDATI:
Lindim Dibra

Tetovë, Maj, 2017

PËRMBAJTJA

FALENDERIM.....	4
ABSTRAKT	5
ABSTRACT.....	6
QËLLIMET E HULUMTIMIT	7
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	7
HIPOTEZAT.....	8
KAPITULLI 1.....	9
1. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË STRUGËS	9
1.1 Themelimi	9
1.2 Organet dhe mënyra e zgjedhjes së tyre	9
1.2.1 Këshilli Komunal	10
1.2.2 Kryetari i Komunës.....	11
1.2.3 Administrata lokale.....	12
1.3 Kompetencat dhe llojet e tyre	14
1.3.1 Kompetencat vetanake	14
1.3.2 Kompetencat e deleguara.....	15
1.3.3 Kompetencat e caktuara (përbashketa)	16
2. KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË QEVERISJES LOKALE	17
2.1 Demokracia dhe vetëadministrimi lokal	17
2.2 Administrimi lokale si kategori e sistemit politik.....	17
2.3 E drejta e qytetarëve për pjesëmarrje në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në zgjidhjet e punëve me karakter lokal.....	18
2.4 Financimi i NJVL	19
2.5 Kompetencat e VQL	20
2.6 Ndarja territorial në NJVL	21
2.7 Bashkëpunimi i vetëqeverisjes lokale	22
2.8 Bashkëpunimi i organeve të pushtetit qendror me organet e pushtetit vendor	25
2.9 Mbrojtja juridike dhe administrimi lokale	26
3. Bashkëpunimi i Komunës së Strugës me institucionet tjera	27
3.1 Bashkëpunimi me ELEM.....	27
KAPITULLI 2.....	29
1. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË OHRIT.....	29
1.1 Themelimi	29

1.2 Organet dhe mënyra e zgjedhjes së tyre	30
1.2.1 Këshilli i komunës	30
1.2.2 Kryetari i komunës.....	32
1.2.3 Administrata komunale.....	33
1.3 Kompetencat e komunës	35
1.3.1 Kompetencat vetanake	35
1.3.2 Kompetencat e deleguara.....	35
1.3.3 Kompetencat e caktuara (përbashkëta)	36
3. Bashkëpunimet e Komunës së Ohrit me komunat tjera.....	37
3.1 Bashëkpunimi me Komunën e Pogradecit.....	37
3.2 Bashëkpunimi me Komunën e Budvës	41
3.3 Bashëkpunimi me Komunën Edessa (Воден) Greqi	42
KAPITULLI 3.....	43
1. PJESA EMPIRIKE	43
1.2 Konstatimi nga rezultatet e pyetësorit si dhe nga gjendja faktike	46
2. SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE.....	48
SHKURTESA TË PËRDORURA	49
LITERATURË E SHFRYTËZUAR.....	50
Dokumente Juridike të konsultuara	51

LISTA E FIGURAVE

Figure 1. Stema e komunës së Strugës.....	9
Figure 2. Stema e komunës së Ohrit	29
Figure 3 Marrveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Ohrit dhe Komunës së Pogradecit....	38
Figure 4 Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet R. Maqedonisë dhe R. Shqipërisë për Liqenin e Ohrit	40
Figure 5 Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Ohrit dhe Budvës.....	41
Figure 6 Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Ohrit dhe Komunës Voden - Greqi	42
Figure 7 Grafikoni i te intervistuarve ne K.Struges per pyetjen 1	43
Figure 8 Grafikoni i te intervistuarve ne K. Ohrit per pyetjen 1.....	44
Figure 9 Grafikoni i te anketuarve ne te dy komunat per pyetjen 2	45
Figure 10 Djegja e tallave në bregun e Liqenit të Ohrit	46

FALENDERIM

Në mënyrë të veçantë falenderoj familjen time babain, nënën dhe dy motrat e mia që në çdo moment më kanë qëndruar pranë dhe nuk janë bezdisur nga kërkesat e mia. Andaj, këtë sukses ua dedikoj atyre në shenjë respekti dhe falenderimi.

Shpreh falënderimet më të sinqerta për mentorin tim Prof. Dr. Agni Aliu, për orientimet dhe mbështetjen e tij të çmuar në realizimin e këtij studimi, për dedikimin dhe kujdesin e vazhdueshëm që ka treguar gjatë kësaj kohe deri në finalizimin e tij. Pa vërejtjet dhe sugjerimet e tij nuk do të kisha mundur ta kryeja këtë studim. Gjatë gjithë studimit jam ndjerë i mbështetur nga këshillat e tij, informacionet dhe komentet e dobishme për mbarëvajtjen e punimit të magistraturës. Falenderoj dhe ju shpreh mirënjohje gjithashtu dhe antëtarëve të komisionit për, këshillat, sygjerimet dhe bashkëpunimin tonë.

Falenderimi ju shkon dhe përfaqësuesve të Komunës së Strugës, Komunës së Ohrit dhe Komunës së Pogradecit, si dhe të gjithë punonjësve të administaës dhe qytetarëve që u bënë pjesë e këtij punimi me intervistat dhe anketat anonime.

Dhe së fundmi do të doja të shprehja mirënjohje ndaj të gjithë personave që nga afër apo larg kanë treguar interes për punimin tim.

* * *

ABSTRAKT

Bashkëpunimi i njësive të vetëqeverisjes lokale është një ndër karakteristikat themelore të vetëqeverisjes lokal dhe sa herë që flasim për vetëqeverisje lokale nuk mund të lëmë anash rëndësinë e veçantë që ka kjo karakteristikë për vetëqeverisjen lokale. Bashkëpunimi i njësive të vetëqeverisjes lokale është i rëndësishëm për faktin se mundëson rritjen dhe efikasitetin e realizimit të interesave të qytetarëve dhe ju mundëson atyre të jenë të kënaqur me shërbimet e shpejta cilësore dhe efikase.

Shkëmbimi i kuadrove dhe përvojave gjatë projekteve të përbashkëta çdo herë është frytdhënës prandaj dhe bashkëpunimi është i domosdoshëm si ndërmjet komunave, ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal, ndërmjet komunave kufitare dhe ndërmjet organizatave, fondeve dhe komunave jashtë vendit.

Për rëndësinë e bashkëpunimit të njësive të vetëqeverisjes lokale flet edhe fakti se bashkëpunimi si një nga karakteristikat themelore të VQL-së përfshihet edhe në konventat ndërkombëtare dhe dispozitat juridike brenda shtetit.

Mendoj se ky hulumtim do të jetë një kontribut minimal në këtë fushë të rëndësishme dhe do të shërbej për gjeneratat e reja që të vazhdojnë studimet rreth menaxhimit të Liqenit të Ohrit dhe Drinit të Zi për të shfrytëzuar mundësinë që qytetarët ti shijojnë të mirat që i sjellin këto dy resurse ujore si në aspektin e zhvillimit ekonomik ashtu edhe në aspektin e zhvillimit të turizmit.

Gjetja e formave të reja të bashkëpunimit në mes këtyre dy komunave dhe fondeve ndërkombëtare mundëson që pushteti lokal të rrisë shkallën e zhvillimit dhe të jetë në gjendje të ofrojë shërbime sa më kualitative me projekte të ndryshme të përbashkëta. Prandaj duhet të shtohet shkalla e kujdesit dhe marrjes së masave nga ana e organeve të pushtetit qendror dhe organeve dhe institucioneve të ndryshme të pushtetit lokal.

ABSTRACT

The cooperation of local government units is one of the essential characteristics of local self-government and how much time talking to local self-government can not set aside the special importance of this feature for local government. The cooperation of local government units is important because it enables growth and efficiency of the realization of the interests of citizens and enables them to be satisfied with the rapid and efficient quality services.

The exchange of personnel and experiences shared during the project every time fruitful and therefore cooperation is necessary as between municipalities, between central and local government, between the border municipalities and between organizations, funds and municipalities abroad.

The importance of cooperation between local self-governments confirmed by the fact that cooperation as one of the essential characteristics of local self-government is included in international conventions and legal provisions in the country.

I think that this research will be a minimal contribution in this important area and will serve for future generations to continue studies on the management of the Lake Ohrid and the Black Drin to exploit the opportunity for citizens to enjoy the benefits they bring these two water resources in terms of both economic development and tourism development.

Finding new forms of cooperation between these two municipalities and international funds enables the local governments to increase the degree of development and be able to provide better quality services to various joint projects. Therefore, we need to increase the level of care and the measures taken by the central authorities and various bodies and institutions of local government.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Raporti i organeve të pushtetit qendror dhe lokal dhe bashkëpunimi i NJVL-së janë karakteristika themelore të qeverisjes lokale, prandaj në vazhdim do të analizojmë organizimin dhe funksionimin e bashkëpunimit të Komunës së Strugës dhe Komunës së Ohrit lidhur me menaxhimin e Liqenit të Ohrit dhe Drinit të Zi. Qëllimi kryesor është që të rritet niveli më i lartë i zhvillimit të shumë fushave si ato ekonomike, turizmit, tregtisë, etj.

Përmes bashkëpunimit të NJVL-ve mundësohet dhe menaxhimi me resurset natyrore fitimprurëse të Liqenit të Ohrit. Vëmendje e posaçme duhet ti kushtohet zhvillimit të komunave gjë që paraqet një nevojë të domosdoshme për menaxhimin e drejtë të Liqenit të Ohrit dhe Drinit të Zi. Çështje kjo që do të mundësojë zhvillimin e komunave ndërsa zhvillimi i tyre paraqet një tregues se në çfarë niveli ndodhet bashkëpunimi i këtyre komunave në raport me njëra tjetrën, por edhe në raport me organet e pushtetit qendror.

Ky hulumtimi ka të bëjë me analizën e karakteristikave themelore të vetëqeverisjes lokale në përgjithësi dhe me bashkëpunimin e Komunës së Ohrit dhe Komunës së Strugës në veçanti në fushën e menaxhimit të resurseve ujore dhe atë të Liqenit të Ohrit dhe Drinit të Zi.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi në fjalë ka një rëndësi të veçantë prandaj për realizimin e këtij hulumtimi janë përdorur metodat: historike, sociologjike, krahasuese. Gjithashtu gjatë këtij hulumtimi do të përdoren një numër i teksteve universitare të autorëve të ndryshëm si nga vendi ashtu edhe autorëve ndërkombëtarë, konventa ndërkombëtare, Kushtetuta dhe Ligjet që i referohen kësaj fushe, punime të botuara nga autorë të ndryshëm lidhur me bashkëpunimet e vetëqeverisjes lokale.

HIPOTEZAT

Nga studimet dhe rezultatet e arritura gjatë këtij hulumtimi arrimë në hipotezat se cilët janë faktorët që ndikojnë në bashkëpunimin në mes dy komunave lidhur me menaxhimin drejt dhe efikas të Liqenit të Ohrit dhe Drinit të Zi. Si dhe hipotezë kryesore:

H. Bashkëpunimi në mes Komunës së Strugës dhe Komunës së Ohrit në menaxhimin e një resursi të përbashkët (Liqenin e Ohrit dhe Drinit të Zi) nuk është në nivelin e duhur.

KAPITULLI 1

1. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË STRUGËS

1.1 Themelimi

Komuna e Strugës është një ndër komunat më të rëndësishme të RM-së, ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 507 km², në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë, ndërsa qyteti i Strugës në një lartësi mbidetare 698 metrave, në brigjet e Liqenit të Ohrit dhe lumit Drini i Zi, i cili e ndan qytetin në dy pjesë. Në këtë komunë jetojnë qytetarë të nacionaliteteve të ndryshme (shqiptarë, turq, maqedonas, vlleh, romë, etj) në gjithësej 50 vendbanime, të cilët përmes përfaqësuesve të tyre që ato i zgjedhin kërkojnë mbështetje në plotësimin dhe përmirësimin e kushtëve jetësore.



Figure 1. Stema e komunës së Strugës

1.2 Organet dhe mënyra e zgjedhjes së tyre

Duke marrë parasysh faktin se Komuna e Strugës ka një strukturë të përzier të popullatës, zgjedhjet lokale përkalojnë me vështirësi të ndryshme.

Sipas ligjit për vetëqeverisje lokal në RM theksohet se çdo njësi e vetëqeverisjes lokale duhet të posedoj organet e saj qeverisëse dhe atë Këshillin komunal dhe Kryetarin ku në bazë të zgjedhjeve të këtyre organeve Komuna do të organizohet për ti kryer punët e saj sipas nevojave të qytetarëve. Edhe Komuna e Strugës operon në bazë të organeve të saj: Kryetarit, Këshillit dhe Administratës lokale.

1.2.1 Këshilli Komunal

Këshilli i Komunës së Strugës është organ përfaqësues i qytetarëve i cili vendos në suaza të kompetencave të komunës¹. Pra, qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre apo këshilltarët të cilët do të sjellin vendime dhe do të kryejnë punë në interes të komunitetit lokal. Këshilli është trup legjislativ i fokusuar në vendimmarrje, apo sjelljen e akteve nënligjore (Statutin, Vendimet, Rekomandimet, Propozimet, etj).

Numri i anëtarëve të këshillit të çdo njësie të vetëqeverisjes lokale përcaktohet sipas numrit të popullsisë që jeton në kuadër të tyre, i cili nuk mund të jetë më pak se nëntë dhe as më shumë se 33 anëtarë, kjo është e rregulluar me Ligjin për vetëqeverisje lokale të RM-së.

Komuna e Strugës numëron 27 këshilltarë të zgjedhur në zgjedhjet lokale, të drejtëpërdrejta të lira dhe demokratike me votim të fshehtë².

Këshilli i Komunës së Strugës si organ vendimarrës që është udhëhiqet nga Kryetari i Këshillit i cili zgjidhet nga Këshilli me votim publik, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, me mandat katër vjeçar. Propozimi për kryetar të Këshillit mund të vijë nga çdo anëtar i Këshillit.

Kompetencat e Komunës janë të mëdha dhe shtrihen në lëmi të ndryshme. Për këtë paraqitet nevoja e formimit të komisioneve dhe nënkomisioneve të përkohshme dhe të përhershme, si trupa të Këshillit komunal.

Detyrat më të rëndësishme të Këshillit janë: sjellja e statudit dhe akteve tjera nënligjore; të sjell buxhetin e komunës; të përcaktojë tatimet lokale; themelimin e ndërmarrjeve publike dhe mbikqyrjen e punës së tyre; vendos për dhënien e lejeve për kryerje të veprimtarisë me interes publik lokal; t'i miratoj raportet për punën e veprimtarive publike që i ka themeluar komuna; vendos për mënyrën e disponimit me pronën e komunës; vendos mbi mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës, në përputhje me ligjin; shqyrton dhe miraton raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e komunës, që e dorëzon deri tek ministri i punëve të brendshme dhe avokati i popullit; kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj³.

¹ Ligji për vetëqeverisje lokale, Gazeta zyrtare e RM-së, Nr 07-346/1; 2002, Neni 32, Pika 1

² Statuti i Komunës së Strugës, 2002, Neni 14

³ Statuti i Komunës së Strugës,

Puna e këshillit në përgjithësi është në funksion të asaj për çfarë është themeluar. Këshilli është i ndërtuar nga këshilltarët e zgjedhur në zgjedhjet lokale ku vendos shumica. Në rastet kur subjekti politik nuk e krijon shumicën e nevojshme në Këshill, ekziston mundësia e krijimit të koalicioneve me subjektet tjera politike dhe kështu plotësohet parimi themelor i vendosjes së shumicës. Opozita në të shumtën e rasteve e kryen funksionin e saj në korrigjimin e punës së pozitës në Këshill.

1.2.2 Kryetari i Komunës

Në bazë të Statutit të Komunës së Strugës, Kryetari është kompetent për: iniciimin dhe propozimin e sjelljeve të dispozitave nga kompetencat e Këshillit; e siguron kryerjen e punëve të cilat me ligj i janë deleguar komunës; e propozon buxhetin vjetor të komunës dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës; e realizon buxhetin; vendos në punët administrative për të drejtat, obligimet, dhe interes të personave juridik dhe fizik, në përputhje me ligjin; udhëheq me administratën komunale; emëron dhe shkarkon të punësuarit në administratën komunale; sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës për administratën komunale; kryen punë të tjera të përcaktuara me lidh dhe statut.

Edhe Kryetari i Komunës edhe anëtarët e Këshillit komunal zgjidhen nga vota e popullit. Në zgjedhjet lokale në RM aplikohen të dy sistemet zgjedhore edhe ai proporcional edhe ai i shumicës. Këshilltarët zgjidhen në bazë të sistemit proporcional sipas D'Hondt metodës, ku të gjitha partitë e regjistruara politike në mënyrë të pavarur ose në koalicion, si dhe grupe të zgjedhësve paraqesin listë të kandidatëve për këshilltar komunal. Kandidatët dhe përkrahësit e tyre patjetër duhet të jenë nënshkruar maqedonas, si dhe të jenë banues në komunat ku ata kandidojnë. Qytetarët nuk votojnë për kandidatin/en por për listën e kandidatëve. Sipas D'Hondt metodës, numri i këshilltarëve të zgjedhur të ndonjë liste të veçantë është proporcional me votat e hedhura për atë list⁴. P.sh. në qoftë se 30 përqind e qytetarëve në një komunë të caktuar votojnë për atë listë të kandidatëve të emëruar nga partia Liberale, atëherë 30 përqind e kandidatëve në list zgjidhen këshilltar.

Procedura e nominimit dhe kushtet ligjore për kryetarin e komunës janë identike me ato për këshilltar. Edhe kandidatët për kryetar komune duhet të jenë nënshkruar maqedonas dhe

⁴ Kandevea.E, *Stabilization of Local Governments*, 2000, fq 253

banorë të përhershëm në komunat në të cilat ata janë të emëruar, si dhe të jenë kandidatë të partive politike të regjistruara ose grupe me më së paku 200 qytetarë. Varësisht nga madhësia e NJVL-së, grupet e zgjedhësve duhet të grumbullojnë numër të caktuar të nënshkrimeve: nga 100 nënshkrime për NJVL-të deri në 10,000 banorë, prej më së paku 450 për NJVL-të me mbi 100,001 banorë, ndërkaj për kandidimin për Qytetin e Shkupit nevojiten 1 000 nënshkrime.

Lista e kandidatëve për anëtar të këshillit dhe për kandidat për kryetar të komunës paraqitet në formular të përcaktuar nga KKZ, më së voni 35 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. KKZ-ja i publikon këto lista më së voni 25 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Votuesi e jep votën e tij për njërin nga kandidatët e vërtetuar të cilët gjinden në fletë votim. Përderisa në raundin e parë zgjedhor asnjëri kandidat nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave, do të mbahet edhe raundi i dytë në të cilin do të marrin pjesë dy kandidatë të cilët kanë fituar më shumë vota. Ai kandidat i cili fiton sëpaku një votë më shumë e fiton mandatin. Në R.Maqedonisë modeli zgjedhor i shumicës përdoret gjatë zgjedhjeve për Kryetarin e Republikës dhe gjatë zgjedhjes së kryetarëve të komunave.

1.2.3 Administrata lokale

Për kryerje të obligimeve nën kompetenca të organeve të komunës, themelohet administrata e komunës⁵. Meqë egzistojnë komuna, të cilat sipas numrit të banorëve, territorit dhe zhvillimit ekonomik të tyre janë të ndryshme, jepet mundësi për ato komuna, që do të gjejnë arsyeshmëri, të sjellin vendime për themelimin ose ndërprerjen e trupit të përbashkët administrativ, gjegjësisht administratës së përbashkët. Vendimi për themelim të administratës publike do të konsiderohet i sjellur, nëse ka fituar shumicën e votave të secilit këshill të komunave. Në bazë të vendimeve, komunat do të nënshkruajnë marrëveshje më shkrim, me të cilën rregullohen çështjet, siç janë: selia e trupit administrativ, lloji, sasia dhe mënyra e kryerjes së aktiviteteve, shfrytëzimi i objekteve dhe pajisjeve, financimi, mënyra e ndërprerjes dhe kontrolli i punës.

Administratat komunale, duhet të organizohen në seksione dhe njësi. Gjatë përcaktimit të seksioneve, gjithnjë duhet pasur parasysh madhësinë e komunës, zhvillueshmëria e saj, suazat e

⁵ Ligji për vetëqeverisje lokale, Neni 57, 2002, Gazeta zyrtare e RM, Nr 07-346/1

kompetencave etj. Në çdo rast, administrata komunale nuk mund të ketë më pak se dy seksione. Organizimi dhe funksionimi i Komunës së Strugës ndahet në sektorë, degë dhe njësi dhe duket si në vazhdim:



Tabela 1: Struktura e administratës komunale

1.3 Kompetencat dhe llojet e tyre

Komunat kanë kompetencë të përgjithshme, e cila e përfshin të drejtën, në suazat e ligjit dhe në pajtim me parimin e subsidiaritetit, në territorin e tyre të kryejnë punët me interes publik dhe rëndësi lokale, që nuk janë të përjashtuara nga kompetenca dhe nuk janë nën kompetencë të organeve të administratës shtetërore. Pra, punët e caktuara me interes publik që nuk janë nën kompetencë të organeve shtetërore dhe që nuk janë parashikuar si kompetenca të komunës, këto punë i kryen komuna, si kompetenca të veta. Meqë këto punë, me interes publik nuk janë parashikuar lejohet mundësia që komuna t'i parasheh ato në statutin e saj, pasi çdo komunë ka specifikat e saj në aspekt të zhvillimit, traditave, resurseve, etj. Ka raste kur në një komunë egzistojnë punë të caktuara me interes publik, e në një komunë tjetër jo.

Duke i përcaktuar punët me interes publik në statut, komunat do të përcaktojnë edhe mënyrën e kryerjes së tyre. Shembull: Komuna e Strugës në territorin e saj ka Liqenin e Ohrit. Rregullimi i bregut të Liqenit dhe përshtatja e tij për përdorim si plazhë publike në këtë moment nuk është dhënë si kompetencë e pavarur e Komunës e as që është nën kompetencë të ndonjë organi të pushtetit shtetërorë si kompetencë ekskluzive (por është kompetencë e përbashkët). Për këtë, Komuna e Strugës, në territorin e së cilës gjendet Liqeni i Ohrit, ka kompetencë të kryej këtë punë me interes publik, ndërsa administrimi bëhet në përputhje (bashkëpunim) me Ministrinë e Lidhjes dhe Transportit.

Për shkak se kompetencat komunale janë të shumëllojshme dhe gjithanshme për ti kuptuar sa më mirë më e drejt do ishte një lloj ndarje apo grupimi i tyre në kompetenca vetanake, kompetenca të deleguara dhe kompetencat e përbashkëta⁶.

1.3.1 Kompetencat vetanake

Kompetencat vetanake janë kompetencat kryesore që i kanë komunat dhe në kuadër të të cilave kanë të drejtë t'i rregullojnë dhe menaxhojnë lirshëm çështjet komunale. Ushtrimi i këtyre kompetencave duhet të bëhet në të mirë të popullsisë së komunës dhe në përputhje me standardet dhe kushtet e aplikueshme për këto kompetenca të përcaktuara me ligj.

⁶ Aliu.A dhe Stavileci.E, *Qeverisja lokale* (Tetovë, SH.A. Napredok, 2009), fq 136

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive që i referohen interesit lokal në fushat: zhvillimin lokal ekonomik; planifikimin rural dhe urban; zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës; zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal; mirëmbajtjen dhe ofrimin e shërbimeve komunale dhe publike, përfshirë furnizimin me ujë, menaxhimin e mbeturinave, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale; reagimin ndaj rasteve emergjente lokale; ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, përfshirë regjistrimin dhe licensimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor publik; ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç janë kujdesi për të cënueshmit, strehimi familjar, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit, përfshirë regjistrimin dhe licensimin e qendrave të kujdesit shëndetësor; punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale; banimin publik; shëndetësinë publike; emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike; turizmin; aktivitetet kulturore dhe të lira; çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër⁷.

1.3.2 Kompetencat e deleguara

Kompetencat e deleguara janë kompetenca të nivelit qendror të cilat zbatohen nga komunat me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët. Nëse një organ i administratës shtetërore vlerëson se kryerja e punëve të caktuara do të jetë më efikase nëse kryhet nga niveli lokal i qeverisjes gjegjësisht nga komuna atëherë ky organ kompetencat për kryerjen e këtyre punëve i delegon në nivel lokal. Komuna, aq sa është e mundur, mund të ushtrimin e këtyre kompetencave me kushtet lokale. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që komunës t'i ofrohet fond i nevojshëm për ushtrimin e kompetencave të deleguara; këto fonde duhet të jenë në një nivel të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme të komunës të bëra në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave⁸.

⁷ Statuti i Komunës së Strugës, Neni 15

⁸ Ligji për vetëqeverisje lokale, 2002, Gazeta zyrtare e RM, Nr 07-346/1; Neni 23, Pika 2

1.3.3 Kompetencat e caktuara (përbashkëta)

Kompetencat e zgjeruara vetanake janë ato kompetenca që rrjedhin nga një proces asimetrik i decentralizimit, me qëllim të plotësimit më të mirë të nevojave të komuniteteve. Kur një ligj u jep kompetenca të shtuara vetanake një grupi të caktuar të komunave, këto kompetenca të shtuara duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë me kompetencat e tjera vetanake.

Kompetencat e zgjeruara (përbashkëta) janë kompetencat që kryhen në bashkëpunim të organeve të pushtetit lokal dhe pushtetit qendror si p.sh: nxjerrja e planit gjeneral të urbanizmit, për të cilin organi i administratës shtetërore kompetent e jep pëlqimin, nxjerrja e planit urbanistik të detajuar dhe e dokumenteve të urbanizmit për vendet e banuara të NJVL për të cilat organi kompetent i administratës jep pëlqimin pasi ti ketë konsultuar dhe organet dhe organizatat tjera të përcaktuara me ligj.

Kompetente për zgjidhjen e mosmarrveshjeve që mund të shfaqen ndërmjet kompetencave midis NJVL dhe organeve të pushtetit qendror është Gjykata Kushtetuese.

Vendimi i Gjykatës Kushtetues është i plotëfuqishëm.

2. KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË QEVERISJES LOKALE

2.1 Demokracia dhe vetëadministrimi lokal

Maqedonia është Republikë parlamentare demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit si dhe balancimit në mes tyre. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe respekton Kartën Europiane për Vetëqeverisjen Lokale.

Institucionet e administrimit lokale dhe zyrtarët e zgjedhur zbatojnë praktika e mekanizma efikase që mundësojnë komunikimin dyanësh midis tyre dhe zgjedhësve. Vetëadministrimi lokal është e drejtë e qytetarëve në organizimin në nivel lokal me qëllim të drejtimit, vendosjes së punëve lokale dhe kjo paraqet një ndër të drejtat themelore demokratike të shoqërisë moderne.

Për të realizuar vetëadministrim lokal modern dhe efikas qytetarëve duhet tju sigurohen të drejta të caktuara si: e drejta që në komuna drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të vendosin për punë që janë të rëndësishme për jetën dhe zhvillimin e njësisë së vetëadministrimit lokal pa ndikimin e organeve qendrore. Pra, lidhshmëria mes qeverisjes lokale dhe demokracisë qëndron në faktin se ky organizim i qeverisjes lindi si nevojë dhe kërkesë e qytetarëve për të vendosur dhe për të udhëhequr me punët dhe çështjet lokale. Dhe meqë populli si masë e gjërë nuk mund të qeverisë, vendos që të zgjedh përfaqësuesit e tij legjitim mbi të cilin e bart sovranitetin e tij.

Kjo mund të konsiderohet si vlerë demokratike për një shtet pasi ai arrin të nxit dhe më shumë qytetarët për të qënë sa më afër dhe përcjellës aktiv të jetës politike që ndodh në qytetin apo shtetin e tyre.

2.2 Administrimi lokale si kategori e sistemit politik

Vetëadministrimi lokale promovon sjelljen demokratike, transparencën dhe llogaridhënien. Ajo duhet të garantojë një sistem kontrolli të ndërsjellë në nivel komunal për ta

parandaluar keqpërdorimin e pushtetit. Pushteti lokal realizohet përmes funksionimit të ekzekutivit dhe legjislativit të tij.

Zanafilla e krijimit, zhvillimit dhe standartizimit të vetëadministrimit lokale në Republikën e Maqedonisë mund të gjendet në një numër aktesh ndërkombëtare, më e rëndësishmja nga të cilët është Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Meqë kjo Kartë përcakton vetëm parimet themelore të vetëqeverisjes në komunitetet lokale, kërkohet një rregullore më gjithëpërfshirëse. Qeverisja lokale duhet të jetë e mbështetur në Kushtetutë dhe Ligje për të qënë një institucion kushtetues dhe ligjor.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ajo është një bashkësi e banorëve të një rrethi të caktuar e vërtetuar me ligj, ku nëpërmjet organeve, administratës dhe shërbimeve publike të saj, mundëson kryerjen e kompetencave me ligj ku komunat njihen si persona juridik⁹. Garantimi kushtetues dhe ligjor i vetëqeverisjes lokale si kategori e sistemit politik bën që tek qytetarët të rritet besimi në vlerat demokratike të shtetit.

Në pjesën e pestë të Kushtetutës së RM-së parimisht është e vërtetuar pozita e saj kushtetuese në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë. Qytetarëve të RM-së Kushtetuta ua garanton të drejtat e vetëqeverisjes lokale duke vërtetuar karakterin demokratik të saj¹⁰.

2.3 E drejta e qytetarëve për pjesëmarrje në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në zgjidhjet e punëve me karakter lokal

Pjesëmarrja publike paraqet domosdoshmëri për ushtrimin e demokracisë në nivelin lokal. Kjo d.m.th. se qytetarëve duhet t'u ofrohen mundësi të bollshme për të ndikuar në mënyrën si qeveritë e tyre funksionojnë gjatë mandatit të tyre.

Një ndër parimet bazë të Kartës Evropiane për vetëadministrimin lokal është pjesëmarrja e qytetarëve në udhëheqjen e punëve publike (neni 4), si indikator për karakterin demokratik të sistemit politik të çdo shtetasi veçmas.

⁹ Ligji për vetëqeverisje lokale, 2002, Gazeta zyrtare e RM, Nr 07-346/1, Neni 2, paragrafi 1, Pika 1

¹⁰ Ligji për vetëqeverisje lokale të RM, 2002, Neni 114, Paragrafi 1

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale “Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve” është përfshirje individuale ose kolektive e banorëve të komunës në sjelljen e vendimeve për punë me rëndësi lokale në nivele të ndryshme të zgjidhjes.

Kjo e drejtë që qytetarëve ju njihet me ligj realizohet përmes tubimeve të popullatës, iniciativës së qytetarëve apo përmes referendumit dhe tërthorazi përmes zgjedhjeve lokale ku qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në organet e komunës¹¹.

Marrja pjesë e qytetarëve në zgjedhjet e punëve me karakter lokal publik në fakt tregon se vetëqeverisja lokale përpos se merr dimension politik dhe ekonomik ajo ka dhe elementin shoqëror e cila në mënyrë direkte ndikon brenda jetesës së një komuniteti lokal.

2.4 Financimi i NJVL

Sigurimi i mjeteve financiare është shumë i rëndësishëm për krijimin e kushteve për realizimin e kompetencave. Idetë e mëdha nuk vlejnë asgjë, nëse nuk kanë mbështetje financiare. Kryetarët e komunave gjatë kohës së punës, janë të angazhuar në kërkimin e mbështetjes për projektet, gjetjen e partnerëve, sigurimin e fondeve etj.

Në RM financimi i komunave është i rregulluar me ligj të posaçëm. Sipas Ligjit për financimin e vetëqeverisjes lokale burime të financimit të komunave janë: burimet vetanake të të ardhurave, dotacionet prej buxhetit qëndror si dhe nga buxhetet e fondeve dhe me huazim.

¹²Burimet vetanake të të ardhurave janë të ardhura, që sigurohen nëpërmjet *tatimeve lokale* (tatimi i pronësisë; tatimi i trashigimisë dhe dhuratës; tatimi i qarkullimit të patundshmërive dhe tatime tjera lokale të përcaktuara me ligj); *taksave lokale* (taksat komunale, taksat administrative dhe taksa tjera lokale të përcaktuara me ligj); *kompenzimeve lokale* (kompenzimet për rregullimin e tokës ndërtimore, kompenzimet prej veprimtarisë komunale dhe kompenzimet për planet hapësinore dhe urbane dhe kompenzime tjera lokale të përcaktuara me ligj) dhe nga të ardhurat nga pronësia.

¹¹ Ligji për vetëqeverisje lokale i RM-së, Nenet 26, 27, 28, 32, 33;

¹² Ligji për financimin e komunave të RM-së

Të ardhurat nga donacionet në formë të mjeteve financiare, janë të ardhura nga buxheti i RM-së, ndërsa donacionet në sende evidentohen si pronë e komunës. Të gjitha kompetencat që qeveria qendrore ua delegon komunave duhet të shoqërohen me fonde për realizimin tyre. Nga Buxheti i Republikës dhe nga buxhetet e tjera, sigurohen të ardhura plotësuese (huaja, kredi, dotacione, TVSH 3% etj), në formë të dotacioneve për financimin e kompetencave të përcaktuara me ligj dhe për realizimin e projekteve për investime kapitale.

Në listën e gjërë të kompetencave burimore dhe të deleguara është siguruar edhe lista e “gjerë” e të ardhurave financiare për financimin e atyre kompetencave, por me “fyt të ngushtë” në gjenerimin fiskal¹³. Por në fakt burimet vetanake të përcaktuara për financimin e kompetencave burimore sipas ligjit as për së afërmi nuk mjaftojnë si në vëllim ashtu edhe në strukturë, për shkak të:

- Normave të ulta të tatimeve lokale, taksave dhe kompensimeve;
- Sistemeve joefikase të arkëtimit të të ardhurave lokale;
- Shprehisë skajshmërisht të keqe dhe praktikës së menaxhimit me të ardhurat lokale, etj.

2.5 Kompetencat e VQL

Autoritete lokale brenda kornizave ligjore duhet të kenë aftësi vendimmarrëse për ushtrimin e iniciativave të tyre që nuk janë parashtruar nga kompetencat e tyre ose të caktuara nga ndonjë autoritet tjetër¹⁴.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale, do të konsultohen në mënyrë dhe në kohë të përshtatshme, gjatë procedurës së planifikimit dhe vendosjes për çështjet që kanë të bëjnë me ato. Në këtë drejtim, Konventa parasheh mundësinë që kryerja e disa kompetencave të bartet mbi pushtetin lokal, si dhe informimin me kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për procedurën e planifikimit dhe vendimmarrjes për çështje, që kanë të bëjnë me ato.

¹³ Bexheti.A, *Financat publike*, (Tetovë, Arbëria Design, 2007), fq 441

¹⁴ Karta Evropiane për Vetëqeverisje lokale, Strasburg, 1985, neni 4

Fushëveprimi i vetëqeverisjes lokale përfshihet dhe përfaqësohet në aktivitetet e komunave në ushtrimin e kompetencave burimore dhe atyre të deleguara nga pushteti qendror, në kuadër të bashkësisë lokale. Kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale, sipas ligjit, janë të plota dhe nuk mund të mirren ose kufizohen, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

Si rregull është që disa punë të jenë në kompetencë të organeve lokale dhe një pjesë tjetër tju takojë organeve qendrore.¹⁵ Kompetencat e organeve lokale paraqesin burim të rëndësishëm të fushëveprimit të organeve të administrimit lokale. Kurse sa u përket kompetencave të organeve qendrore ato realizohen në dy mënyra dhe atë përmes njësive rajonale të organeve qendrore, ose përmes bartjes të punëve të organeve të pushtetit lokal.

2.6 Ndarja territoriale në NJVL

Në vitin 1996 Ligji mbi ndarjen territoriale parashihte 123 komuna dhe Qytetin e Shkupit si njësi të veçantë të vetëadministrimit lokal. Edhe pse ky segment më vonë është rregulluar me ligj të posaçëm siç është Ligji për organizim territorial të vitit 2004 ku numri i NJVL u zvogëlua në 83 komuna dhe Qytetin e Shkupit ende paraqitet si një nga fushat më të rëndësishme dhe më të debatueshme. Jo vetëm tek ne por kjo problematikë thellohet më shumë sidomos në shtetet multietnike dhe në shtetet që janë në zhvillim e sipër. Shumë subjekte ndërkombëtare janë të gatshëm të japin kontributin e tyre në tejkalimin e kësaj problematike në këto shtete.

Kur flasim për ndarjen territoriale nuk duhet anashkaluar edhe disa faktorë si: numri i popullatës, sipërfaqja e territorit të bashkësisë lokale, kufijtë e interesit lokal, kapacitetin financiar ekonomik të vetëqeverisjes lokale, homogjenitetin dhe gravitimin e punëve kah institucione të rëndësishme (universitete, shkolla, spitale), etj¹⁶.

Sipas Konventës evropiane për VQL kufijtë e territorit, në të cilin shtrihen të drejtat dhe detyrimet e pushtetit lokal, nuk guxon të ndryshohen pa konsultim paraprak të NJVL-ve në fjalë. Ky konsultim duhet të bëhet me referendum, nëse është e paraparë me ligj.

¹⁵ Aliu.A dhe Stavileci.E, *Qeverisja lokale* (Tetovë, SH.A. Napredok, 2009), fq 31

¹⁶ Aliu.A dhe Stavileci.E, *Qeverisja lokale* (Tetovë, SH.A. Napredok, 2009), fq 32

2.7 Bashkëpunimi i vetëqeverisjes lokale

Sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe “bashkëpunim” do të thotë kryerja e një vepre apo veprimtarie nga dy apo më shumë subjekte me marrëveshje ndërmjet tyre. Marrëdhënie është lidhja e ndërsjellë bashkëpunimi, ndihmë e bashkëveprim ndërmjet dy a më shumë njerëzve, palëve, shteteve, organizatave etj”, në një fushë të veprimtarisë politike, shoqërore a ekonomike a në punë të ndryshme; të dhënë a të marrë ndërmjet dy a më shumë vetave, palëve etj, qëndrim që mbajnë kundrejt njëri tjetrit¹⁷.

Edhe bashkëpunimi ndërmjet të NJVL-ve është i nevojshëm për realizimin e interesave të përbashkëta lokale. Dhe kjo është e garantuar edhe me Konventën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Kjo e drejtë ju garantohet NJVL-ve për zhvillimin e pushtetit lokal, përforcimin e kapaciteteve institucionale e njerëzore të komunës, përmirësimin e kualitetit jetësor të qytetarëve etj.

Bashkëpunimi ndërkomunal në Maqedoni ka filluar nga nevoja për të ofruar shërbime cilësore si dhe për përmirësimin e burimeve publike, bashkëpunime të cilat kanë sjellë deri tek përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike.

Bashkëpunimi ndërkomunal ndërmjet komunave bëhet që të arrihen sa më lehtë qëllimet e definuara si interes i përbashkët i dy apo më tepër komunave.

¹⁸Përfitimet e përbashkëta që mund të llogariten si rezultat nga BNK për institucionet lokale, qendrore dhe të grupeve të tjera të interesit janë:

- 1) Ndarja e roleve dhe obligimeve si dhe menjanimin e dublifikimit të shërbimeve, ndërmjet komunave. I njëjti shërbim mund të jepet nga një institucion i përbashkët për dy apo më tepër komuna me qëllim të zvogëlimit të kostos së shërbimit duke i shfrytëzuar mjetet dhe resurset njerëzore në mënyrë më racionale.
- 2) Zvogëlimi i harxhimeve. Nëse një shërbim jepet për një hapësirë dhe me popullsi më të madhe çmimi i shërbimit për njësi zvogëlohet në masë të madhe. Kjo ju ndihmon

¹⁷ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë, 1981, fq 1064

¹⁸ Instituti për Studime të politikave interkulturore, *Raport mundësi për bashkëpunim ndërkomunal*, Maqedoni, Maj 2009, fq 21

komunave që të kursejnë dhe dobitë janë të dyanshme, kursehet buxheti i komunave që do të thotë taksa më të ulta për taksapaguesit.

- 3) Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit tek komunat në dhënjen e shërbimeve të caktuara nëpërmjet bashkëpunimit me komunat fqinje. Mjetet që përdoren për shërbim por edhe resurset njerëzore kanë koeficient më të lartë të shfrytëzueshmërisë. Zvogëlohen harxhimet për administratën komunale dhe mundësia e ngritjes profesionale është më e madhe.
- 4) Bashkëpunimi ndërkomunal është një mundësi për të shfrytëzuar më racionalisht administratën tek komunat e vogla por edhe për të zvogëluar rrezikun e dështimit. Komunat e vogla shpeshherë në mungesë të administratës profesionale dështojnë në dhënjen e një shërbimi të caktuar apo atë e bëjnë me kualitet shumë të dobët. Tek komunat e mëdha rritet kontrolla mbi administratën dhe kualitetin e ofrimit të shërbimit. Adminsistratat që japin shërbime për një numër më të madh klientësh kanë mundësi të bëhet më profesioniste dhe të ekipohet më mirë.
- 5) Rriten hapësirat e dhënies së shërbimeve të caktuar që jepen në një teritor të definuar. Duke dhënë shërbim në më tepër komuna nga një administratë e përbashkët në një teritor të caktuar qytetarët kanë më tepër mundësi për më tepër alternativa. Ato mund të njëjtin shërbim ta marrin kudo që ndodhen në teritorin ku operon ajo administratë e përbashkët. Kjo njihet edhe si “shërbim mobil” apo “administratë antenë”: Kjo do të thotë se kudo që gjendet qytetari mund të merr shërbimin për të cilin ka nevojë. Këtë mund ta bëjë edhe nëse gjendet jashtë territorit të komunës së vetë (fal zhvillimit të teknologjisë moderne kompjuterike dhe bazave të të dhënave që bëhen me mundësinë që në to të ketë qasje prej çdo pjese të territorit ku operon një shërbim i përbashkët i më tepër komunave).
- 6) BNK mundëson rritjen e kapacitetetve për devolucion apo dekoncentrim më të zgjeruar të kompetencave. Ekonomia dhe njëllojshmëria e shërbimeve janë të një rëndësie të veçantë për transfer të kompetencave. BNK rrit gjasat për decentralizim të mëtutjeshëm. Që të mund të ju barten kompetenca shtesë nga pushteti qendror në atë vendor fillimisht nevoiten kapacitete administrative dhe mjetet të tjera. Komunat e vogla apo edhe ato më të varfëra zakonisht nuk plotësojnë këto kapacitete. Ndaj, qytetarët e këtyre komunave nuk janë në gjendje të barabartë me qytetarët tjerë që jetojnë në komuna më të zhvilluara dhe me kapacitete më të mëdha. P.sh, marrja e letërnjoftimit apo pasaportës që janë në

kompetencë të pushtetit qëndror, shumë lehtë mbi parimin e dekoncentrimit mund të barten tek zyrat komunale.

¹⁹Përpos përfitimeve të drejtpërdrejta nga bashkëpunimi ndërkomunal shpesh hasen edhe përfitime indirekte apo anësore. Si përfitime të tilla paraqiten:

- Ndarja e përgjegjësiave dhe roleve, (komunat i ndajnë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet veti, që dmth se ato edhe specializohen për lëmi të ndryshme);
- Dobi për partnerët në shfrytëzimin e resurseve financiare, njerzore, infrastrukturore, teknologjike, etj. Kjo mund të konsistoj në krijimin e “bazenit të përbashkët të resurseve dhe shërbimeve”, nga i cili bazen çdo komunë që merr pjesë në BNK merr shërbimet e duhura;
- Ndarja e rrezikut dhe kontrolla më e mirë nga fitimi: Disa investime janë edhe investime me risk të lartë. Me BNK ndahet risku por edhe fitimi;
- Vlerë e shtuar tek shërbimet dhe prodhimet. Rritja e kapacitetit kadrovik, ekipimi rrit nivelin e kualitetit në shërbim;
- Fleksibiliteti. Bashkëpunimet ndërkomunale mund të vendosen edhe përkohësisht, mund të kenë periudhë provues por edhe pilot projekte ku mund të testohet qëndrueshmëria e një projekti.
- Ka edhe përfitime të tjera anësore që nuk janë studiuar sa duhet, por ka tregues serioz se ato mund të krijojnë mundësi dhe përparësi edhe në shumë lëmi tjera.

¹⁹ Përsëri aty, fq 22

2.8 Bashkëpunimi i organeve të pushtetit qendror me organet e pushtetit vendor

Për ta kuptuar më mirë raportin ndërmjet pushtetit lokal dhe atij qendror më e drejtë do ishte që në fillim të bejmë dallimin ndërmjet tyre. Pushteti qendror ka të drejten e veprimit në të gjithë territorin e vendit, kurse pushteti lokal shtrihet dhe vepron në ndonjë hapsirë të caktuar lokale. Në mënyrë më të përgjithësuar pushteti qendror i referohet centralizimit ndërsa pushteti lokal decentralizimit.

Organet qendror me organet e pushtetit lokal kanë marrëdhënie reciproke. Për të rregulluar raportin ndërmjet tyre egzistojnë tre mundësi²⁰:

- ✓ Pavarësia e plotë e njësive të vetëadministrimit lokal (siç e paraqiste teoria marksiste e komunave)
- ✓ Pavarësia jo e plotë e vetëadministrimit lokal që shprehet vetëm në nivel lokal të pushtetit shtetëror (siç egziston në shtetet centraliste),
- ✓ Sistem i përzier, sipas të cilit njësitë e vetëadministrimit lokal për kryerjen e disa punëve gëzojnë pavarësi të plotë, ndërsa për disa kanë varshmëri nga pushteti shtetëror.

Pushteti qendror dhe ai lokal duhet që patjetër të njohin kompetencat vetanake dhe të njëri tjetrit. Duke njohur rolet dhe përgjegjësitë e njëri tjetrit ato kryejnë punë më efikase dhe më efektive si në delegimin e kompetencave ashtu edhe në kontrollin e kryerjes së tyre.

Në Kushtetutën e RM-së, theksohet se vlerë themelore e rendit kushtetues është parimi i ndarjes së pushteteve në legjislativ, egzekutiv, gjyqësor. Sipas Kushtetutës kemi dy ndarje territoriale administrative. Pjesa e parë ju takon organeve qendrore qeveritare dhe agjensioneve të tyre (Kuvendi i Republikës, Kryetari i Republikës, Qeveria e Republikës, Gjyqësia dhe Prokurori publik). Ndërsa si pjesë e veçantë trajtohet sistemi i vetëadministrimit lokal.

Organet e pushtetit qendror disponojnë intrumente me të cilat bëjnë kontrollin dhe ushtrojnë ndikim në organet e vetëqeverisjes lokale si: kontrolli financiar, emërimi i nëpunësve,

²⁰ Aliu.A dhe Stavileci.E, *Qeverisja lokale* (Tetovë, SH.A. Napredok, 2009), fq 33

informimi për punën etj. Kur organet e pushtetit lokal kryejnë punë të besuara nga ana e organeve të pushtetit qëndror, ato i nënshtrohen një kontrolli hierarkik të organeve qëndrore²¹.

Një raport apo marëdhënie e mirë mundëson përforcimin e demokracisë në shtet me çka ndihmohen edhe proceset demokratike. Kjo lidhshmëri midis këtyre pushteteve ndikon drejtëpërsëdrejti mbi zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin politik. Por raporti i tyre ndryshon nga shteti në shtet sidomos në shtetet e centralizuara dhe decentralizuara.

2.9 Mbrojtja juridike dhe administrimi lokale

Sipas Kartës Evropiane për Vetëqeverisje lokale çdo NJVL ka të drejtë për mjete juridike me qëllim sigurimi të ushtrimit të lirë të detyrave të veta dhe respektimit të parimeve të vetëqeverisjes lokale të përcaktuara me kushtetutë ose ligjet e vendit që i takojnë²². Një gjë e tillë do të bëhet përmes gjykatave të rregullta, gjykatave kushtetuese, gjykatës së veçantë apo gjykatës administrative, varësisht nga mbrojtja ligjore në shtetet përkatëse.

Korniza ligjore vendore për qeverisjen lokale trajton dhe ju garanton me ligj të drejtën e mbrojtjes juridike që nënkupton egzistimin e mekanizmave juridik për realizimin e nevojave me karakter lokal. Organet lokale mund të kërkojnë mbrojtje juridike pranë gjykatave kompetente për aktivitetet e organeve të administratës shtetërore, me të cilat pengohet kryerja e kompetencave të përcaktuara me kushtetutë dhe ligj.

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale është Konventa e parë ligjor shumëpalësh që përcakton dhe garanton parimet e autonomisë vendore, një ndër shtyllat e demokracisë, mbrojtja dhe zhvillimi i së cilës është detyrë e Këshillit të Evropës. Mund të shpresohet që në këtë mënyrë, ajo do të japë një kontribut thelbësor për mbrojtjen dhe zgjerimin e vlerave të përbashkëta të Evropës.

²¹ Përsëri aty, fq 33

²² Karta Evropiane për Vetëqeverisje lokale, 1985, Strasburg, neni 11

3. Bashkëpunimi i Komunës së Strugës me institucionet tjera

3.1 Bashkëpunimi me ELEM

Ndërmjet Komunës së Strugës dhe ELEM egziston një marrëveshje ku Komuna e Strugës ka për detyrim të mirëmbaj, menaxhojë Liqenin e Ohrit, lugun dhe brigjet e Drinit të Zi, kurse ELEM e shfrytëzonë Drinin e Zi si resurs të saj in për prodhimin e energjisë elektrike. Në bazë të kësaj marrëveshje ELEM i detyrohet Komunës ti paguaj 1% të kostos së prodhimit. Kjo është e rregulluar me ligjin për ujë në RM dhe paraqitet si më poshtë:

Neni 213

Përcaktimi i tarifës për përdorimin e ujit

- (1) tarifa për përdorimin e ujit për konsumim nga njerëzit, për mbrojtjen dhe furnizimin e bagëtive është 2% të çmimit të përcaktuar për metër kub të ofruesit të shërbimeve për ujë,
- (2) Detyrues për pagimin e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni është çdo personi fizik ose juridik i cili përdor ujë nga sistemi i furnizimit me ujë
- (3) Tarifa e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni do të llogaritet nga personi juridik i cili menaxhon sistemin e furnizimit me ujë dhe i ngarkuar me mbledhjen e tarifave për furnizimin me ujë të shërbimit dhe paraqitet veçmas në marrjen e shërbimit.
- (4) Personi juridik i nga paragrafi (3) i këtij neni, duhet një herë në muaj të paguajë pagesën nga paragrafi (1) i këtij neni, në një pages të veçantë në llogari të thesarit
- (5) Tarifa e paguar për shfrytëzimin e ujit për ujitje është 2% të çmimit të përcaktuar për metër kub të ofruesit të shërbimeve të ujit për furnizimin me ujë
- (6) Pagues për pagesën dhe llogaritjen e kompensimit sipas paragrafit (5) të këtij neni është çdo person fizik ose juridik i cili përdor ujë nga hidro dhe/ose sistemin e ujitjes
- (7) Tarifa e përmendur në paragrafin (5) të këtij neni do të llogaritet nga personi juridik që operon sistemin hidro apo sistemin e ujitjes dhe të ngarkuar me mbledhjen e tarifave për furnizimin me ujë të shërbimit dhe të paraqitet veçmas në marrjen e shërbimit
- (8) Personi juridik i përmendur në paragrafin (7) të këtij neni, duhet një herë në muaj të paguaj taksën nga paragrafi (5) i këtij neni në një fletëpages të veçantë në llogarinë trezore.
- (9) Lartësia e pagesës e cila paguhet për shfrytëzimin e ujit për kullimin e tokave është 1% për hektar nga çmimi i përcaktuar i tokës ngadhënësi i shërbimit për kullimin e tokave
- (10) Obligues për pagesën dhe për llogaritje të shpërblimit nga paragrafi 9 i këtij neni është çdo person fizik dhe juridik, toka e të cilit kullohet nga sistemi i kullimit.

- (11) Pagesën për paragrafin 9 të këtij neni e përllogarit personi juridik i cili menaxhon me sistemin e kullimit dhe e pagon me parapagesë të çmimit për shërbimin e kryer të sistemit të kullimit, këtë e paraqet veçmas nga llogaria për shërbimet e kryera
- (12) Personi juridik i përmendur në paragrafin (11) të këtij neni, është i obliguar një herë në muaj të paguaj shpërblim nga tarifat e mbledhura nga paragrafi (9) i këtij neni, në një fletëpagesë të veçantë në llogari trezore.
- (13) **Tarifa e paguar për shfrytëzimin e ujit në prodhimin e energjisë elektrike është si vijon:**
- a. **1% të kostos së prodhimit të një kilovat orë në pragun e termocentralit në hidrocentralet dhe**
 - b. 0.5% të kostos së prodhimit të një kilovat orë të termocentralit pragut në bimët termoelektrik
- (14) Pagues për pagesën dhe llogaritjen e kompensimit nga paragrafi (13) i këtij neni është person juridik që prodhon energji elektrike.
- (15) Tatimpaguesi sipas paragrafit (14) të këtij neni, është i obliguar një herë në muaj të paguaj tarifat e mbledhura nga paragrafi (13) i këtij neni, në një fletëpagesë të veçantë në llogari trezore.

KAPITULLI 2

1. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË OHRIT

1.1 Themelimi

Komuna e Ohrit bën pjesë në grupin e komunave më të zhvilluara në RM, ajo shtrihet në pjesën jugperëndimore të shtetit dhe është e vendosur në bregun verilindor të Liqenit të Ohrit në një lartësi mbidetare prej 695 m. Ajo ka një sipërfaqe prej 384 km², me 28 vendbanime dhe një popullësi prej 55,749 banorëve. Qendra e komunës është qyteti i Ohrit, i cili ka një histori dhe kulturë të lashtë, me një florë dhe faunë të rrallë në Liqenin e Ohrit.



Figure 2. Stema e komunës së Ohrit

Ohri është një qytet i "gjallë turistik" që dymijë e katërqind vjet, trashëgimtar i ligjshëm i qytetit të Lyhndës, me një qytetërim të lashtë të fisit ilir Dasaretët. Ohri ishte kryeqyteti më i rëndësishëm zyrtar i shtetit të parë sloveno-maqedonas, të mbretërisë së Samuilit. Liqeni i Ohrit është gjithashtu një trashëgimi botërore kulturore dhe natyrore nën mbrojtjen e UNESCO-s që nga viti 1980²³.

Turizmi është një nga lëmit më të rëndësishme socio-ekonomike në Ohër. Për shkak të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të saj që është e vendosur në këtë zonë. Prandaj, kur kemi parasysh zhvillimin ekonomik të kësaj zone, turizmi është një nga aktivitetet më të rëndësishme pasi që paraqet një përshpejtues të jetës sociale dhe ekonomike të qytetit.

²³ <http://www.ohrid.gov.mk/index.asp?novostiID=143>, shikuar më 29, Qeshor 2016

1.2 Organet dhe mënyra e zgjedhjes së tyre

Komuna, si njësi themelore apo bazike e qeverisjes lokale, përfaqëson një unitet administrativ-territorial dhe bashkësi banorësh. Ajo përbëhet prej dy organeve themelore: Këshillit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës. Mënyra e organizimit të këtyre dy organeve e mundëson funksionimin komplementar të njëra tjetrës dhe që të dy organet zgjidhen drejtpërdrejt nga vota e qytetarëve.

Edhe komuna e Ohrit ka Statutin e saj në bazë të së cilit egzistojnë dhe funksionojnë organet e saj, Këshilli komunal dhe Kryetarti.

1.2.1 Këshilli i komunës

Këshilli i Komunës përbëhet nga këshilltarët e tij, të zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët e Komunës së Ohrit, me mandat katër vjeçar. Përfaqësimi i qytetarëve bëhet në bazë të një formule, që u siguron përfaqësim qytetarëve në vendimmarrje. Këshilli udhëhiqet nga Kryesuesi i Këshillit. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga rradhët e anëtarëve të Këshillit.

Komuna e Ohrit aktualisht numëron 23 këshilltarë të zgjedhur në zgjedhje lokale, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë²⁴.

Këshilli vendos me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm në të, së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit. Statuti, buxheti, llogaria përfundimtare e buxhetit dhe rregullorja e punës së Këshillit miratohen me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Për të debatuar çështjet brenda kompetencave të tij, Këshilli formon komisione. Komisionet e Këshillit të përhershme dhe të përkohshme. Mandati i komisioneve të përhershme zgjat për aq kohë sa është mandati i Këshillit.

²⁴ Statuti i Komunës së Ohrit, 2014, Neni 17

Komisionet e përhershme të Këshillit janë si më poshtë²⁵:

- 1 • Komisioni i Ligjeve - Statutor
- 2 • Komisioni për Financa dhe Buxhet
- 3 • Komisioni për verifikim, zgjedhje dhe emërim
- 4 • Komisioni për Shërbime Publike
- 5 • Komisioni i Planifikimit Urban
- 6 • Komisioni për Punë Sociale
- 7 • Komisioni për turizmin dhe zhvillimin ekonomik lokal
- 8 • Komisioni për mbrojtjen e mjedisit
- 9 • Komisioni për qeverisjen lokale
- 10 • Komisioni për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave
- 11 • Komisioni për të shënuar festat dhe ngjarjet dhe çmime dhe mirënjohje

Organet e komunës së Ohrit gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre sjellin akte të përgjithshme dhe akte të veçanta. Me aktet e përgjithshme në mënyrë burimore rregullohen marrëdhëniet, të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe personave juridik në suaza të kompetencave të komunës. Ata përmbajnë norma të përgjithsme juridike që kanë të bëjnë me numër të pakufizuar të rasteve.

²⁵ Statutit të Komunës së Ohrit, Neni 42

1.2.2 Kryetari i komunës

Është autoriteti kryesor ekzekutiv në komunë. Kalimi i zgjedhjes së Kryetarit prej përfaqësuesve të qytetarëve në kuvend, në zgjedhje të drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës përkatëse, ka shtuar kompetencat dhe përgjegjësit e tij/saj në përfaqësimin dhe qeverisjen e komunës. Kryetari merr të gjitha kompetencat ekzekutive në komunë, emëron nënkryetarët e tij dhe drejtorët e drejtorive të administratës komunale. Kryetari krijon politika, organizon dhe udhëheq punën e komunës, menaxhon buxhetin dhe mbikëqyrë punën e komunës, por nuk ka mekanizma të qartë të llogaridhënies.

Kryetari i Komunës së Ohrit është z. Nikolla Bakraçeski, i cili është administrator i qytetit të Ohrit. Do të përmendim disa nga kompetencat e Kryetarit siç janë: kontrolli i ligjshmërisë së dispozitave të nxjerrja nga Këshilli; publikimi i dispozitave në gazetën zyrtare të Komunës; garanton kryerjen e vendimeve të Këshillit; kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të Këshillit; siguron kryerjen e punëve, të cilat me ligj i janë deleguar Komunës; propozon buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit; realizon buxhetin e komunës; merr iniciativ dhe propozon sjelljen e dispozitave të Këshilli i komunës; bën emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve të ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e Komunës; informon Këshillin e komunës për kryerjen e obligimeve të tij në pajtim me statutin e komunës; zgjidh punë administrative për të drejta, obligime dhe interese të personave juridik dhe fizik²⁶.

Për kryerje e këtyre kompetencave, Kryetari i komunës mund të autorizojë nëpunës, udhëheqës zyrtarë të drejtojnë procedurën dhe të vendosë në punë administrative, si dhe të nënshkruajë.

Për ushtrimin e të gjitha këtyre kompetencave, kryetari themelon zyra të ndryshme për punë administrative. Me përshkrimin e kompetencave të zgjeruara dhe me mënyrën e zgjedhjes së kryetarit, më shumë shkohet drejt një organi autonom se sa të një organi vetëqeverisës lokal. Rrjedhimisht kryetari merr edhe rolin e mbikqyrjes së zbatimit të vendimeve të kuvendit të komunës duke qenë përgjegjësi kryesor për punën e komunës dhe zbatimin e akteve të kuvendit. Në aspektin organizativ kryetari nuk ka konflikte funksionale me kuvendin e komunës.

²⁶ Statutit të komunës së Ohrit, Neni 34

1.2.3 Administrata komunale

Komuna e Ohrit ka një administratë komunale ku punojnë kryesisht shërbyes civil, të cilët krijojnë marrëdhënien e punës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre me Ligj.

Organizimi dhe rregullimi i organizatës, fushëveprimi dhe mënyra e kryerjes së detyrave të administruës komunale kryhet me vendim që e sjell Këshilli me propozim të Kryetarit. Administrata komunale, duhet të organizohet në seksione dhe njësi. Gjatë përcaktimit të seksioneve, gjithnjë duhet pasur parasysh madhësinë e komunës, zhvillimin e saj, suazat e kompetencave etj. Si do qoftë, administrata komunale nuk mund të ketë më pak se dy seksione.

Administrata komunale në Komunën e Ohrit organizohet si më poshtë²⁷:

Administrata komunale e Komunës së Ohrit	Sektori për çështje juridike;	Njësia për çështje juridike;
		Njësia për të mbështetjen e Këshillit;
	Sektori për çështjeve të përgjithshme;	Njësia për përkrahje administrative teknike;
		Njësia për prokurim;
		Njësia për teknologji informacioni dhe komunikimi;
	Sektori i çështjeve financiare	Njësia për koordinim të buxhetit;
		Njësia për kontroll buxhetor;
		Njësia e kontabilitetit dhe pagesave;
	Sektori për taksat komunale;	Njësia për taksat;
		Njësia për akuzat e shërbimeve publike;
	Sektori i planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës ndërtimit;	Sektori për planifikime fizike, planifikimin urban, tokës dhe pronës së paluajtshme të komunës;
		Drejtoria për zbatimin e planeve urbanistike;
	Sektori i mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave;	Njësia për mbrojtjen dhe ndikim në mjedis;
		Njësia për menaxhimit të mbetjeve dhe deponitë regjionale;
	Sektori i shërbimeve publike, transportit dhe rrugët;	Njësia për shërbimeve publike;
		Njësia për transport dhe rrugë;

²⁷ Vendim për organizimin, qëllimin dhe mënyrën e ekzekutimit të detyrave të komunës së Ohrit, 2015, Neni 5

	Sektori i zhvillimit ekonomik dhe të turizmit;	Njësia për turizmëm;
		Njësia për zhvillim ekonomik lokal;
	Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar, bashkëpunimi me UNESCO-n dhe kultura;	Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe bashkëpunim me qytetet e binjakëzuara;
		Njësia për UNESCO-n dhe integrimi evropian;
		Departamenti i kulturës;
	Sektori për arsim, fëmijët, shëndetësi dhe mbrojtje sociale;	Njësia për arsim;
		Njësia për fëmijë, shëndetësi dhe mbrojtje sociale;
	Sektori i sportit, rinisë dhe OJQ-ve;	Departamenti i sportit;
		Departamenti për rinin dhe OJQ-të;
	Sektori për mbështetjen e Kryetarit të Komunës;	Njësia e protokollit;
		Njësia për marrëdhënie me publikun;
	Sektori për inspektim – Inspektorati	
	Sektori i burimeve njerëzore;	
	Sektori i auditimit të brendshëm;	
	Sektori për mbrojtje nga zjarri	

1.3 Kompetencat e komunës

Komunat e ushtrojnë autoritetin e tyre në kuadër të juridiksionit të tyre, në mënyrë që t'i realizojnë disa qëllime dhe t'u ofrojnë shërbime banorëve të tyre. Përveç zbatimit të ligjit, komunat mund të nxjerrin dispozita në kuadër të kompetencave të tyre.

Komunat në bazë të ligjit për qeverisje lokale kanë këto lloj të kompetencave si: kompetenca që ato vetë i nxjerrin dhe i ushtrojnë (kompetenca vetanake), kompetenca që organet e pushtetit qendror ua kanë deleguar organeve komunale me qëllim të realizimit sa më efikas dhe efektiv (kompetenca të deleguara), dhe kompetenca që i kryejnë në bashkëpunim me pushtetin qendror (kompetencat e përbashkëta).

1.3.1 Kompetencat vetanake

Komunat janë të pavarura në kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm me karakter lokal, të përcaktuara me ligj, si dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre.

Ligji përbën një listë të gjatë të kompetencave burimore të komunave siç janë: mbrojtjen e mjedisit jetësor; planifikimin urbanistik; veprimtarin komunale; zhvillimin ekonomik lokal; mbrojtjen e fëmijëve dhe mbrojtjen sociale; kulturë; arsimin; sport; shëndetësin primare; etj.

1.3.2 Kompetencat e deleguara

Sipas Ligjit parashihen gjithashtu edhe kompetencat e deleguara nga organet e administratës shtetërore.

Si fillim, delegimi i këtyre kompetencave duhet të shoqërohet edhe me mjetet financiare për realizimin e tyre. Komuna duhet që këto kompetenca ti përshtas në bazë të kushteve lokale dhe përgjegjës për ushtrimin e këtyre kompetencave është organi i administratës shtetërore.

Republika mund të besojë njësitë të vetëqeverisjes lokale edhe një numër të caktuar të punëve që janë në kompetencë të organeve të administratës shtetërore me qëllim që, në mënyrë sa më efikase dhe racionale të realizohen të drejtat dhe detyrat e qytetarëve për plotësimin e disa nevojave të caktuara në interes të qytetarëve.

1.3.3 Kompetencat e caktuara (përbashkëta)

Edhe këto kompetenca janë të njohura nga Ligji, kryhen në bashkëpunim të organeve të pushtetit qendror dhe atyre të pushtetit lokal.

Punët që i kryejnë njësitë e vetëqeverisjes lokale në pajtim me organet kompetente të administratës shtetërore janë: nxjerrja e planit gjeneral të urbanizmit, për të cilin organi i administratës shtetërore kompetent e jep pëlqimin, nxjerrja e planit urbanistik të detajuar dhe e dokumenteve të urbanizmit për vendet e banuara të NJVL-së për të cilat organi kompetent i administratës jep pëlqimin pasi ti ketë konsultuar dhe organet dhe organizatat tjera të përcaktuara me ligj.

Kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të shfaqen ndërmjet kompetencave midis NJVL-ve dhe organeve të pushtetit qendror është Gjykata Kushtetuese.

3. Bashkëpunimet e Komunës së Ohrit me komunat tjera

3.1 Bashkëpunimi me Komunën e Pogradecit

Memorandum Bashkëpunimi

Ndërmjet

Komunës së Ohrit, Maqedoni dhe Komunës së Pogradecit, Shqipëri

Për

Bashkëpunimin e projekteve evropiane dhe për zhvillimin e qëndrueshëm, veçanërisht turizmit alternativ të Rajonit të Liqenit të Ohrit

Komuna e Ohrit, Republika e Maqedonisë dhe Komuna e Pogradec, Republika e Shqipërisë, më poshtë referuar si Palët,

Jemi të ndërgjegjshëm për rëndësinë lokale, rajonale dhe globale të Liqenit të Ohrit, si një vend me vlerë të jashtëzakonshme mjedisore, ekonomike, shkencore, estetike dhe kulturore,

Duke njohur mundësitë për zhvillimin e përbashkët dhe zbatimin e projekteve kryesisht në programet ndërkufitare dhe të tjera evropiane, të ndërgjegjshëm për nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse në mbrojtjen e cilësisë së ujit dhe ruajtjen e integritetit të ekosistemeve tokësore dhe ujore të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit;

Duke kujtuar Deklaratën e angazhimit në krijimin e një biosferë Rezerva Ohër - Prespë, Tetor.02.2012, dhe marrëveshjet e tjera përkatëse ose Memorandumet për Rajonin e Ohrit,

Me qëllim të thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit për realizimin e CBC përbashkët dhe projekte të tjera,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Memorandum of Understanding

Between
The Municipality of Ohrid of Macedonia and Municipality of Pogradec from Albania

For
Cooperation of European and other projects for sustainable development, especially
alternative tourism of the Lake Ohrid Region

The Municipality of Ohrid, Republic of Macedonia and the Municipality of Pogradec, Republic of Albania, hereinafter referred to as The Parties,

Mindful of the local, regional and global significance of Lake Ohrid as a site of exceptional environmental, economic, scientific, aesthetic and cultural value,

Recognizing opportunities for joint development and implementation of projects primarily in European cross-border and other programs, conscious of the need for a holistic approach to protecting water quality and conservation of the integrity ofterrestrial and aquatic ecosystems ofthe Lake Ohrid Watershed;

Recalling Declaration of Commitment on the Creation of a Biosphere Reserve Ohrid – Prespa, October.02.2012, and the others relevant agreements or Memorandums for Ohrid Region,

Aiming at further deepening of the cooperation for the realization of joint CBC and other projects,

Have agreed as follows:

Article 1 **Basic Objectives**

Individually and in co-operation, the Parties shall work in order to:

1. *Provide more intensive cooperation in the field of utilization of European funds and other programs,*
2. *Identification of project ideas for joint development of the crossborder region.*

Article 2 **General Obligations**

Figure 3 Marrveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Ohrit dhe Komunës së Pogradecit

Bashkëpunimi i këtyre dy komunave ka ardhur si rezultat i marrëveshjes më të hershme ndërmjet dy shteteve e cila daton që nga viti 2004. Ku në bazë të marrëveshjes së vitit 2004 ku shtete kanë rënë dakort për mbrojtjen të dyanëshme të Liqenit të Ohrit dhe zhvillimin e qëndrueshmërisë sipas normave të BE-së si dhe që i gjithë Liqeni dhe pellgu i tij të merr statusin Rezervë e Biosferës të UNESCO-s.

Si rezultat i kësaj marrëveshje ka lindur edhe bashkëpunimi i fundit ndërkomunal mes Komunës së Ohrit dhe Prespës për mbrojtjen e Liqenit dhe për zhvillimin e turizmit.

**MARRËVESHJE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E
QËNDRUESHËM TË LIQENIT TË OHRIT DHE
PELLGUT TË TIJ UJËMBLEDHËS**

Qeveria Maqedonase dhe Këshilli i Ministrave të Shqipërisë, këtu e më poshtë të quajtura Palë:

Duke parasysh rëndësinë lokale, rajonale dhe globale të Liqenit të Ohrit si një zonë me vlera të jashtëzakonshme mjedisore, ekonomike, shkencore, estetike dhe kulturore,

Të bindur se një marrëveshje ndërkombëtare është thelbësore për ruajtjen e këtyre vlerave për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, nëpërmjet një mënyre menaxhimi që u lejon Palëve të mbrojnë dhe ruajnë Liqenin e Ohrit dhe pellgun e tij ujëmbledhës, duke mundësuar në të njëjtën kohë zhvillimin e qëndrueshëm të pellgut ujëmbledhës,

Të ndërgjegjshëm për nevojën e përqasjes së integruar të mbrojtjes së cilësive të ujit dhe ruajtjes së integritetit të ekosistemeve tokësore dhe ujore të Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit,

Duke njohur detyrimet përkatëse në veçanti ndaj Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore, Konventës së OKB-së për Diversitetin Biologjik, Konventës për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare, veçanërisht si Habitats Ujore (Konventa e Ramsar-it), Konventës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar (Konventa e Espoo-s), Konventës për Akses në Informacion, për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim-marrje dhe Akses në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (Konventa e Aarhus-it), Konventës për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Habitatet e tyre (Konventa e Bernës) dhe Konventës për Ruajtjen e Specieve Migratore (Konventa e Bonn-it).

Duke parasysh Memorandumin e Mirëkuptimit midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase të nënshkruar më 29 Nëntor 1996 "Për Projektin e Ruajtjes së Liqenit të Ohrit" dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar më 7 Shtator 2000 "Për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm" midis Ministrisë Maqedonase të Mjedisit dhe Planifikimit Fizik dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të Shqipërisë

Duke synuar të thellojnë më tej bashkëpunimin në mbrojtje të Liqenit të Ohrit e të pellgut të tij ujëmbledhës, mbështetur edhe në përvojën e fituar nëpërmjet ndërtimit të sistemit të kolektorit dhe facilitetave të tjera shoqëruese gjatë zbatimit të projektit për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit,

Bien dakord si vijon:

Figure 4 Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet R. Maqedonisë dhe R. Shqipërisë për Liqenin e Ohrit

3.2 Bashëkpunimi me Komunën e Budvës



3.3 Bashëkpunimi me Komunën Edessa (Воден) Greqi



Figure 6 Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Ohrit dhe Komunës Voden - Greqi

Nga intervistat e realizuara në Komunën e Ohrit si dhe nga hulumtimet paraprake konstatuam se Komuna e Ohrit sëfundmi ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Komunën Voden në Republikën e Greqisë. Ky bashkëpunim ka lindur si rezultat i një projekti të përbashkët me Greqinë nga IPA programet. Nga organet e Komunës së Ohrit theksojnë se bashkëpunimi do të zgjerohet si në fushën e arsimit, kulturës, sportit, etj.

KAPITULLI 3

1. PJESA EMPIRIKE

Për marrjen e informacioneve sa më reale rreth bashkëpunimit NJVL-ve në përgjithësi si dhe bashkëpunimit të komunave në fjalë në veçanti janë intervistuar 120 persona, prej të cilëve 40 nëpunës nga Komuna e Strugës, 40 nëpunës nga Komuna e Ohrit si dhe 40 qytetar nga komuna e Strugës dhe Ohrit.

Në intervistat e bëra me nëpunësit e komunave dhe qytetarët e lirë në pyetjet e parashtruar se: Si mendoni sa është i frytshëm: bashkëpunimi i komunave ndërmjet veti, bashkëpunimi me komunat jashtë shtetit, bashkëpunimi me pushtetin qendror si dhe bashkëpunimi me fondet ndërkombëtare?

Janë përgjigjigjur se në Komunën e Strugës 90.4% gjegjësisht 57 prej të intervistuarve janë pro bashkëpunimit të njësive të vetëqeverisjes lokale me njësit tjera, ndërsa 6.3% gjegjësisht 4 prej të anketuarve janë përgjigjigjur jo të sigurt rreth bashkëpunimit dhe 3.2% nuk kanë njohuri. Të dhënat e marra në vijim janë paraqitur në mënyrë grafike




Figure 7 Grafikoni i të intervistuarve në K.Strugës për pyetjen 1

Kurse në Komunën e Ohrit janë përgjigjur se 92.9% gjegjësisht 53 prej tyre se është i domosdoshëm bashkëpunimi i komunës me të gjitha nivelet, 5.2% gjegjësisht tre persona nuk janë të sigurt dhe 1.9% pa përgjigje.

Rezultatet e marra më poshtë janë paraqitur në mënyrë grafike:



Figure 8 Grafikoni i të intervistuarëve në K. Ohrit për pyetjen 1

Kurse pyetjes se si mendoni sa është realizuar bashkëpunimi i Komunës së Ohrit dhe Strugës sa i përket menaxhimit të Liqenit të Ohrit dhe Drinit të Zi? Në intervistat dhe anketat e realizuara në Komunën e Ohrit janë përgjigjur si vijon: 5.2% janë përgjigjur se është realizuar, 7% pjesërisht i realizuar dhe 87.7% nuk është realizuar.

Kurse pyetjes së njëjtë në Komunën e Strugës janë përgjigjur se: 9.5% është realizuar, 11.1% pjesërisht i realizuar dhe 77.7% nuk është realizuar.

Rezultatet e fituara më poshtë janë paraqitur në grafikone:




Figure 9 Grafikoni i te anketuarve ne te dy komunat per pyetjen 2

1.2 Konstatimi nga rezultatet e pyetësorit si dhe nga gjendja faktike

Në Komunën e Ohrit edhe pse bashkëpunimi ndërkomunal është një faktorë i rëndësishëm nuk ka qenë vigjilent në realizimin e tij në nivelin e duhur. Kujdesi ndaj menaxhimit të Liqenit të Ohrit lë për të dëshiruar për faktin se Komuna e Ohrit nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për shfrytëzimin e liqenit si resur ekonomik - turistik por edhe nuk ka ndarë mjete të mjaftueshme për realizimin e projekteve të nevojshme ndërkomunale por edhe ndërkufitare.



Figure 10 Djegja e tallave në bregun e Liqenit të Ohrit

Një dobësi e theksuar është evidente edhe në rastin e djegjes së tallave në bregun e Liqenit të Ohrit me çrast jo vetëm që është bërë një ndotje e madhe e ambientit por edhe është shkatërruar flora dhe fauna e bregut të Liqenit. Mbetemi me shpresë se në të ardhmen organet e Komunës së Ohrit do të jenë më të kujdesshëm dhe do ta rrisin shkallën e përkushtimit për menaxhimin më të mirë të këtij Liqeni.

Organet e Komunës së Strugës viteve të fundit për fat të keq nuk kanë qenë në nivelin e duhur sa i përket bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkufitar, ndërkombëtar lidhur me menaxhimin e Liqenit të Ohrit dhe Lumit Drini i Zi. Një ndër ndotësit kryesor të Liqenit është Lumi Sateska i cili sjell shumë materie erozive dhe bën ndotje permanente pastaj lumi Drini i Zi ndotet edhe nga mos rregullimi i kanalizimit të qytetit, hedhja pa kriter e mbeturinave, etj. Komuna e Strugës në mandatin e fundit katër vjeçar jo vetëm që nuk ka administruar drejt sidomos me plazhet e qytetit dhe qytetin në tërësi në masë jashtëzakonisht të madhe ka hedhur mbeturina në mesin e fushës së Struges dhe ka bërë një ndotje masive të tokës dhe ujrave nëntokësor por përpos saj edhe të ajrit përmes djegjes së këtyre mbeturinave. Komuna e Strugës ka një marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrjen ELEM për mirembajtjen e lugut përkatësisht bregut të lumit Drin i Zi.

2. SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

Bashkëpunimi i NJVL-ve ka një rëndësi të veçantë për realizimin sa më efikase dhe sa me cilësore të nevojave me karakter lokal, për shkak se Komuna ju ofron atyre përmbushjen e nevojave me karakter lokal qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të vet. Pra, Komuna ju ofron shërbime të shpejta dhe më ekonomike prandaj mund të themi se:

- Për shkak të rëndësisë që ka bashkëpunimi i NJVL-ve është çështje që përfshihet me: Konventën Europiane për vetëqeverisje lokale, Kushtetutën dhe ligjin për vetëqeverisje lokale si dhe dispozitat tjera juridike.
- Bashkëpunimi i NJVL-ve rrit shkallën e efikasitetit dhe cilësisë në organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.
- Bashkëpunimi i NJVL-ve kryen marrëveshje bashkëpunimi në mes veti, raporte bashkëpunimi me organet e pushtetit qendror, me komunat jasht vendit dhe organet dhe organizatat ndërkombëtare.
- Vendimet për bashkëpunim të njësive të vetëqeverisjes lokale i merr Këshilli me shumicë votash.
- Duke pasur parasysh faktin se në bregun e Liqenit të Ohrit prej fshatit Podmol në drejtim të qytetit të Ohrit ka ndodhur një katastrofë ekologjike me djegjen e tallave pikërisht aty ku bëhet shumimi natyral i peshkut, kjo tregon për një bashkëpunim jo të mirë dhe për një moskujdes që shkakton shkatërrimin e florës dhe faunës në bregun e liqenit.

SHKURTESA TË PËRDORURA

VQL – vetëqeverisje lokale;

NJVL - njësi të vetëqeverisjes lokale;

BNK- Bashkëpunimi ndërkomunal

BE – Bashkimi Evropian;

RM – Republika e Maqedonisë;

KEVQL – Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale;

ELEM – shoqëri aksionare me kapital shtetëror;

OJQ – Organizatë joqeveritare;

OSBE - Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunimi në Evropë;

UNESCO – United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization;

LITERATURË E SHFRYTËZUAR

- Aliu , A., & Aliu , S. (2012). Juridical Mass for Protection of Waters From Pollutants. Heavy Metals in Water of Lake Ohrid and in Fish. • *Agni Aliu.& Suzana Aliu “Juridical Mass for Protection of Waters From Pollutants. Heavy Metals inInternational Journal of Scientific & Engineering Research - IJSER.*
- Aliu, A., & Stavileci, E. (2009). *Qeverisja lokale - njoftime themelore dhe shqyrtime krahasimtare.* Tetovë, Prishtinë.
- Aliu, A., Bejta, X., Aliu , S., & Ollogu, I. (2014). • Agni Aliu, Cross border cooperation of municipalities reduces pollution of the River Black Drini - Environment and Ecology in the Mediterranean Region . *Kembrixh scolar book .*
- Aziri, E. (2012). *Sistemet politike.* Tetovë.
- Aziri, E. (2012). *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë.* Tetovë.
- Bexheti, A. (2007). *Financat publike.* Tetovë: Arbëria Design.
- Jakupi, X. (2011). *Veteqeverisja lokale dhe shqiptaret ne Maqedoni.* Shkup.
- Kanev, D. (2009). *Menaxhmenti politik.* Shkup.
- Maksuti, M. (2010). *E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë.* Strugë.
- Normann, F. (2011). *Udheheqja me sektorin publik.* Alamina.
- Pollozhani, B. (2010). *E drejta administrative.* SHKUP.
- Siljanovska , G., & Mikov, V. (2000). *Lokalna samouprava .* Skopje: Magor.
- Stavileci, E. (2005). *Nocione dhe parime të administratës publike.* Prishtinë.
- Todorovski, I. (2001). Local Governments in Macedonia. Në E. Kandevev, *Stabilization of Local Governments* (f. 243). Budapest.
- Zendeli, F. (2014). *E drejta administrative.* Shkup.

Dokumente Juridike të konsultuara

- ✓ Konventa Europiane për Vetëqeverisje Lokale
- ✓ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- ✓ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- ✓ Ligji mbi Financimin e Nevojave të Përbashkëta, Shkup 1991
- ✓ Ligji mbi Buxhetin e RM – së, 1991
- ✓ Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, 1995
- ✓ Ligji për kontabilitet të buxheteve dhe shfrytëzuesve të buxheteve, Shkup, 2002.
- ✓ Ligji për përcaktimin dhe mbledhjen e të ardhurave publike, Shkup 2003.
- ✓ Ligji mbi mbrojtjen e mjedisit jetesor Shkup,
- ✓ Ligji mbi mbrojtjen e Liqenit të Ohrit , Liqenit të Prespes dhe Liqenit të Dojranit , Shkup 1993.
- ✓ Ligji mbi ndarjen territoriale, Shkup, 2004
- ✓ Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat sendore, Shkup, 2001
- ✓ Ligji mbi ujrat, Shkup, 2008
- ✓ Ligji mbi koncesionet, Shkup, 2008.
- ✓ Ligji për tatimin e pronës, Shkup 2004.
- ✓ Ligji për taksat komunale, Shkup, 2004.
- ✓ Ligji për revizion shtetëror, Shkup 2004.
- ✓ Ligji për furnizime publike, Shkup 2004.
- ✓ Ligji mbi Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes lokale, 2005
- ✓ Ligji për Zhvillimin e Barabartë Rajonal, Shkup 2008
- ✓ Doracak për Kryetarët dhe Këshilltarët e Komunave në RM, Shkup 2005